



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË

Nr. 458, prot.

Ersekë, më 25.02.2019

Lënda: Kërkesë për ripajisje me Aktin e Përputhshmërisë për Dokumentet e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Kolonjë.

**Drëjtuar: Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit
TIRANË**

**Nga: Bashkia Kolonjë,
ERSEKË**

Bazuar në nenet 9 dhe 23 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar si dhe ne VKM nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit, **kërkojmë ripajisjen me Aktin e Përputhshmërisë për Dokumentet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kolonjë, të ndryshuar sipas komenteve të lëna nga Këshilli Bashkiak.**

Proçesi i hartimit të dokumentit të Olanit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Kolonjë ka filluar pas nënshkrimit të Akt-Marveshjen midis Ministrisë së Zhvillimit Urban (MZHU) dhe Bashkisë Kolonjë e lidhur më datë 23.01.2017 me asistencën teknike të Operatorit Ekonomik "Atelier 4" sh.p.k.

Më pas, në zbatim të ligjit Nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Kryetari i Bashkisë si autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit të plotë të PPV-së, ka marrë vendimin për marjen e Nismës për hartimin e PPV-së të Bashkisë Kolonjë, si dhe ka ngritur grupin e punës, të cilët janë përgjegjës për hartimin e këtij dokumenti.

Gjatë hartimit të PPV-së janë zhvilluar vizita në terren, janë realizuar katër dëgjesa publike, si dhe takime me Administratorët e Njësive Administrative, Kryepleqtë e fshatrave si dhe persona të tjerë të interesuar për zhvillimin e Bashkisë Kolonjë. Gjithashtu çdo proçes është konsultuar dhe bashkërenduar me AKPT-në.

Për sa më lart, Bashkia Kolonjë në bashkëpunim me studion konsulente pas finalizimit të dokumentit të PPV-së dhe përpara miratimit në Këshillin Bashkiak të këtij dokumenti, ka kërkuar prane AKPT-së, pajisjen me Aktin e Përputhshmërisë. AKPT-ë më datë 28/08/2018 dhe nr. 1036 prot., ka pajisur Bashkinë Kolonjë me Aktin e Përputhshmërisë.

Më pas, Bashkia Kolonjë në bashkëpunim me AKPT-në ka bërë reflektimet në dokumentin e PPV-së sipas ndryshimeve të kërkuara nga Këshilli Bashkiak.

Ndodhur në kushtet e mësipërme dhe përpara se dokumenti i PPV-së të dërgohet për ri-miratim në Këshill Bashkiak, kërkojmë nga AKPT-ë ri-pajisjen me Akt të Përputhshmërisë për të gjitha pjesët e ndryshuara/ndërhyra ne PPV-ë.

Bashkëlidhur kësaj shkrese është dhe CD me të gjithë materialin e Draft Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kolonjë.

